



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

633-22-7524-1-2-1/C583

KOMUNA E ISTOGUT – Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, zyrtar përgjegjës i prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

"Shkambi " Sh.p.k., Zona Industriale, ISTOG, me NURB 810296039 të cilën e përfaqëson z. Musa Metaj, në cilësinë e drejtorit të ndërmarrjes, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV numër identifikues: 633-22-7524-1-2-1

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratë publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV

<i>Nr. i prokurimit</i>	633-22-7524-1-2-1/C583
I brendshëm	633-22-043-1-2-1/C583

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj

kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëratë përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit të sajë dhe planit për menaxhim të kontratës dhe perfundon më së larti deri më datë **08.09.2024**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **10** ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjës nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë rrugët e rendit IV në teritorin e Komunës së Istogut

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP1 (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi.

Vlera e kontratës për periudhën 24 Mujore është: **74.250,00 dhe me shkronja Shtatëdhjetekatërmijëedëdhjetëeuro** Derivimi i lejuar nga vlera totale indikative është **+ - 30 % sipas LPP dhe RRUOPP**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë]

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikime

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues
Komuna e Istogut**

Emri:	Gëzim Ademaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

**Për Furnizuesin
"Shkëmbi" Sh.p.k.,**

Emri:	Musa Metaj
Pozita:	Drejtor,
Nënshkrimi:	
Data:	05.09.2022
Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

633-22-1009-1-2-1/c 583

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe
Siguria e ekzekutimit	8.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës do të bëhet nga kontraktori në një afat prej 25 mujsh, nga data e nënshkrimit të kontratës në vlerë 10% e kontratës.
Sigurimi	9.1	Pjese e dosjes së tenderit
Vonesat e ekzekutimit	14.1	Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise.
Cilësia e furnizimeve	16.2	Artikujt duhet të jenë të kualitetit me specifikat e parapara, bazuar në pershkrimin teknik të ofertës.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Menaxheri i kontratës janë të caktuar Naser Nimanaj, zyrtar i lartë për Infrastrukturë Rrugore nga DDSHP dhe Enisa Çoroviq, zyrtare për Kordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve nga ZLKK me vendim nga ZKA-ja Nr. 671/22 datë. 09.09.2022 të cilët do të bëjnë implementimin e kontratës dhe planin për menaxhimin e kontratës.
Dorëzimi	19.3	Bazuar në pershkrimin e ofertës
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Komisioni Komunal, me perfagesues nga drejtoratet (njësit e kërkesës) me se paku tri takime
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Ekonomike-Departamenti për çështje ekonomike-Prishtinë

KOMUNA E ISTOGUT

TITULLI I AKTIVITETIT: " RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV "

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Nr.	Specifikimi i punëve	Njësia (1)	Sasia e përafert (2)	Cmimi/ Njesi (3)	Gjithsejt (2x3)
1	Furnizimi dhe Transporti i zhavorit (zhavori - materiali prej gurit te thyer gelqeror 0 - 31.5 mm)	m ³	800	4	3200
2	Furnizimi, Transporti dhe Shpërndarja e zhavorit me Grejder (zhavori - materiali prej gurit te thyer gelqeror 0 - 31.5 mm)	m ³	7500	8	60000
3	Planifikimi dhe Gërmimi me Bulduzer apo me Grejder	orë	80	50	4000
4	Furnizimi me gypa betoni Ø 500	copë	50	10	500
5	Furnizimi me gypa betoni Ø 800	copë	15	10	150
6	Furnizimi me kapak betoni për mbulimin e pusetave	copë	40	10	400
7	Hapja e kanaleve anësore	m'	3000	2	6000
TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT					74,250.0 €